



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L -237

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-042 PËR
PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-042
PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Neni 1

Pas nenit 60 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 60.A me tekstin si në vijim:

Neni 60.A
Përparësia për Ofertuesit Vendor

1. Gjatë aplikimit të kriterit të ofertës më të favorshme ekonomike dhe në situatat me oferta të dorëzuara nga ofertuesit vendor dhe të huaj, të cilët ofrojnë shërbime, kontratë furnizimi ose kryejnë punë, autoriteti kontraktues përzgjedhë ofertën e ofruesit më të favorshëm vendor, me kusht që dallimi në shumën finale të pikave të mbledhura ndërmjet ofertës më të favorshme të ofertuesit të huaj dhe ofertës më të favorshme të ofertuesit vendor nuk është më e lartë se dhjetë (10) pikë në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.

2. Gjatë aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët të ofruar, dhe në situatat me oferta të ofertuesve vendor dhe të huaj për ofrim të shërbimeve, kontratë furnizimi ose kryerje të punëve, autoriteti kontraktues përzgjedhë ofertën e ofertuesit vendor me kusht që çmimi i këtij ofruesi të mos jetë më i lartë se pesëmbëdhjetë përqind (15%) në krahasim me çmimin më të ulët të ofruar nga ofruesi i huaj.

3. Në çmimet e ofertuesve, kalkuloohen të gjitha taksat, tatimet dhe tarifatat doganore e aplikueshme në Kosovë.
4. Ofertuesi vendor është person juridik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimet në të hyra të personave juridik ose person fizik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimin në të hyra të qytetarëve.
5. Në rast të ofertës së përbashkët, grupi i ofertuesve konsiderohet si ofertues vendor nëse secili anëtar i grupit është person i referuar në paragrafin 4 të këtij neni.
6. Ofertuesi konsiderohet si ofertues vendor, nëse ofertuesi dhe nën-kontraktori janë persona të referuar në paragrafin 4 të këtij neni.
7. KRPP nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për mënyrën e dëshimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij neni.

Neni 2

Pas nenit 134 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 134.A me tekstin si në vijim:

Neni 134.A Zbatimi i këtij ligji

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të zbatohen në përputhje me afatet e përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L -237
20 mars 2014**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI